



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 3709 prot.

Himarë, më 05.07.2024

### NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, Bashkia Himarë, njofton shpalljen për:

- 1 ( një ) vend i lirë pune në pozicionin: Kryeinspektor i IMT-së, në inspektoratin e mbrojtjes së territorit, në Bashkinë Himarë.**
- 2 ( dy ) vende të lira pune në pozicionin: Inspektor i IMT-së, në inspektoratin e mbrojtjes së territorit, në Bashkinë Himarë.**

#### **PËRSHKRIMI I PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN KRYEINSPEKTOR I IMT-SË ËSHTË:**

- Përfaqëson inspektoratin në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për organizimin, funksionimin, cilesinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së IMT-së;
- Nxjerr urdhra pune për mbarëvajtjen e punës dhe veprimtarinë e IMT-së,
- Bashkërendon veprimtarinë e inspektoratit me institucionet në fushën e veprimtarisë së tij;
- Siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit në nivel vendor;
- Raporton periodikisht drejtperdrejt Kryetarit të Bashkisë për veprimtarinë e IMT-së;
- Zbaton dhe administron buxhetin e miratuar për IMT-në, në perputhje me legjislacionin në fuqi dhe përgatit propozimet për vitin e ardhshëm, të cila ia përcjell strukturës përgjegjëse për buxhetin në bashki.

## **PËRSHKRIMI I PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN INSPEKTOR I IMT-SË ËSHTË:**

- Ushtron funksionet ligjore për mbrojtjen e territorit, brenda kufijve administrative të Bashkisë Himarë;
- Ushtron kontroll në territorin e Bashkisë, veçanërisht te subjektet e ndërtimit, sipas planit të miratuar më parë nga kryeinspektori;
- Pasqyron veprimtarinë e punës në procesverbalin e konstatimit, të cilin ia dorëzon kryeinspektorit;
- Merr pjesë në ekzekutimin e vendimeve për prishje të objekteve të paligjshme brenda territorit të bashkisë;
- Ndjek dhe zbaton urdhërat dhe detyrat e dhëna nga kryeinspektori gjatë ushtrimit të kontrolleve;
- Dokumenton punën e bërë në ushtrimin e detyrës me aktet proceduriale të miratuara;
- Administron sipas ligjit dokumentacionin e depozituar nga subjektet fizike e juridike pranë IMT-së.

## **KËRKESAT E PËRGJITSHME PËR KANDIDATËT:**

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

## **KANDIDATËT DUHET TË PLOTËSOJNË KRITERET E VEÇANTA SI VIJON:**

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” ose “Master Shkencor apo Profesional”, në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.
- b) Të kenë eksperiencë pune deri në 1 vit, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera, në profesion.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.

## **DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:**

### **Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:**

- a- Kërkesë për aplikim;

- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:  
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumente/219-udhezime-dokumente>
- c- Fotokopje të diplomës dhe lista e notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Certifikatë familjare;
- g- Certifika personale;
- h- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- i- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- j- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

***Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Bashkisë Himarë, brenda datës 05.08.2024.***

## **BASHKIA HIMARË**

**Drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse**

